



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P.440/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Jonaïd Myzyri | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Lindita Skeja | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 09.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Montal” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-58406-05-18-2020, me objekt Loti 3 “F.V “*Pajisje radiologjike*” me fond limit 25,666,667 (njëzet e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “BNT Electronics” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:**

BOE “Saer Medical” shpk & “Helath&Light” shpk  
Rruga “Themistokli Gërmenji”, Pallati 11, Shkalla 4,  
Ap.5 Tiranë

“BNT Electronics” shpk  
Blv Zhan D’ark, Ndërtesa 32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1  
Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale  
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.05.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr.REF-58406-05-18-2020, me objekt Loti 3 “F.V “*Pajisje radiologjike*” me fond limit 25,666,667 (njëzet e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 04.08.2020 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 20.08.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

|                     |            |                |
|---------------------|------------|----------------|
| - BNT Electronics   | 15,373,710 | I skualifikuar |
| - Montal            | 16,545,000 | I kualifikuar  |
| - Saer Medical      | 17,400,000 | I kualifikuar  |
| - O.E.S Distrimed   | 18 100 000 | I kualifikuar  |
| - Medfau            | 18,685,000 | I skualifikuar |
| - Fedos             | 19,990,000 | I kualifikuar  |
| - Biometric Albania | 20,970,000 | I kualifikuar  |
| - Albaphoto         | 22,000,000 | I kualifikuar  |
| - Linear            | 23.866.000 | I skualifikuar |

II.4. Në datën 24.08.2020 BOE “Saer Medical” shpk & “Health&Light” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Kemi informacion se kompania e klasifikuar e para nuk ka paraqitur një ofertë të pranueshme teknike. Më konkretisht për pajisjen Mamografi Dixhitale është kërkuar në specifikimet teknike :*
- *Ërkstation*
- *Të instalohen në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitorë LCD min 19’’ me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të*

përfshihet CD/DVD regjistruar. Nëpërmjet kësaj kërkesë teknike kuptohet qartazi një ëorkstation që shërben për rishikimin e imazheve të mamografisë pasi e kërkon të jetë instaluar në dhomën e diagnostikimit (dhomën ku jepet diagnoza, dhoma e mjekut), përveç asaj normales që vendoset në dhomën e ekzaminimit (të teknikut të radiologjisë). Gjithashtu kërkesa për dy monitorë nënkupton qartazi që kërkohet një ëorkstation rishikimi (stacioni i punës i mjekut) pasi nuk ka si të kërkohen dy monitorë për konsolën e mamografisë kur ajo nuk është e pajisur me Stereotaksi apo biopsi. Jemi të bindur dhe kemi informacion që operatori ekonomik Montal shpk i renditur i pari nuk ka përfshirë në ofertën e tij një ëorkstation rishikimi por vetëm konsolën e mamografisë të pajisur me dy monitorë nga të cilët njëri nuk ka për të qenë funksional dhe tregon që oferta nuk është e plotë. KY fakt duhet të verifikohet dhe kompania e renditur e para duhet të skualifikohet pasi oferta e saj nuk është konform specifikimeve teknike të kërkuara në procedurën e prokurimit.

- Oferta jonë është e plotë dhe përfshin përveç konsolës edhe një ëorkstation rishikimi (RËS) i cili është i pajisur me dy monitorë 5 Mega Pixel dhe jo 2 Mega Pixel sic është kërkuar. Arsyeja se përse kemi ofruar 2 monitorë 5 Mega Pixel është sepse një ëorkstation rishikimi mamografie me monitorë me rezolucion më pak se 5 Mega Pixel nuk është i certifikueshëm CE. Këtë fakt mund ta verifikoni lehtësisht. Pra oferta jonë është lehtësisht më e shtrenjtë pasi ne kemi përfshirë në ofertë një ëorkstation rishikimi me dy monitorë medical grade 5 mega picel të certifikuar CE sipas ligjit shqiptar për pajisjet mjekësore. Vlera e këtij ëorkstation në treg i kalon 2,500,000 lekë.
- Aq të vërteta janë faktet e mësipërme saqë në procedurën me objekt prokurimi FV pajisje mjekësore Mamografi me fond limit 33,333,334 lekë pa tvsh , ref-65048-07-10-2020 publikuar në datë 13.07.2020 ku kërkohen dy mamografi digitale me kërkesa identike me procedurën e prokurimit në fjalë pasi janë kërkuar sqarime për këtë kërkesë është qartësuar dhe janë modifikuar kërkesat nëpërmjet shtojcës duke specifikuar se ëorkstation i kërkuar ishte ëorkstation rishikimi me dy monitorë secili me nga 5 mega pixel. Fakti që nuk e kërkuam sqarimin edhe në procedurën e parë është pasi situata është e qartë por pasi pamë në shtyp që tenderat në shëndetësi po orjentohen tek operatorët Montal shpk dhe OES Distrimed na bëri që të kërkonim dhe këtë sqarim.
- Mendojmë se institucioni juaj nuk mund të bëjë procedura prokurimi me dy standarte prandaj kemi besimin e plotë që pretendimet tona të verifikohen dhe kompania e kualifikuar e para të skualifikohet për mospërbushje të specifikimeve teknike.

II.5. Në datën 31.08.2020 me shresën nr.2073/104 prot BOE Saer Medical” shpk & “Health&Light” ka marrë dijeni lidhur me mospranimin e ankesës nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 09.09.2020 pala ankimuese BOE “Saer Medical” shpk & “Health&Light” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Në datën 20.08.2020 operatori ekonomik “BNT Electronics” shpk, është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon.

- Dokumentacioni i paraqitur për plotësimin e kriterëve të vecanta për kualifikim (KVK) rezulton jo i plotë dhe nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e përcaktuar në DST, konkretisht:
- 1. Pika 2.3, Kapaciteti teknik: Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale: Sipas pikës 2.3.7 në KVK kërkohet Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga MSHMS. OE ka ngarkuar në SPE dokumentin Autorizim\_per\_tregtim\_te\_pajisjeve\_mjekesore, i cili rezulton me afat vlefshmërie deri më 30.06.2020. Ndërkohë kjo procedurë prokurimi është hapur më datë 04.08.2020, pra OE ka patur kohën e mjaftueshme për të ngarkuar në SPE autorizimin për tregtim të pajisjeve mjekësore të vlefshëm.
- 2. Në Kreun II, seksioni I të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, konkretisht Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, për lotin 3, 2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në [eëë.app.gov.al](http://eëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).

Në specifikimet teknike të aparatit të mamografisë:

- 2.1. Është kërkuar në DST Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqendrim afërsisht 0,1 -0,3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, specifikimi teknik lidhur me materialin e Anodës dhe materialin për filtrimin e rrezeve X nuk është markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjendet në katalog. Gjithashtu, OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimin të specifikimeve teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për specifikimin teknik të lartpërmendur përcakton vetëm fokusin 0.1mm/0.3mm, pa përmendur materialin e Anodës dhe materialin për filtrimin e rrezeve X.

- 2.2. Është kërkuar në DST Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, ky specifikim nuk është markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjendet në katalog. Gjithashtu, OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimit të specifikimeve teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për këtë specifikim ka deklaruar N/A, pra që nuk aplikohet faktor zmadhimi. Si rrjedhojë, nuk plotëson kërkesën sipas DST.
- 2.3. Është kërkuar në DST Distanca nga burimi tek imazhi 65-66 cm, ndërsa në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, rezulton SID(source to image distance)  $\geq 600\text{mm}$ , e cila është një vlerë dysHEME që nuk garanton kërkesën sipas DST.
- 2.4. Është kërkuar në DST Ëorkstation: Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, rezulton Hard disc 500GB, duke mos plotësuar kështu kërkesën sipas DST.
- 2.5. Është kërkuar në DST Ëorkstation: I pajisur me Ups 1000VA.... Sistem operativ Ëindoës 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, këto specifikime teknike nuk janë markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjenden në katalog. OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimit të specifikimeve teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për specifikimet teknike të sipër cituara ka deklaruar Ok, por duke qënë se OE në këtë rast nuk është vetë prodhues, por nënkontraktor i autorizuar nga prodhuesi, deklarimi në ofertën teknike nuk krijon besueshmëri për plotësimin e specifikimeve për UPS dhe sistemin operativ për Ëorkstation

II.8. Në datën 27.08.2020 "BNT Electronics" shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- Për sa i përket arsyes së parë të skualifikimit ku pretendoni se Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale: Sipas pikës 2.3.7 në KVK kërkohet Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga MSHMS. OE ka ngarkuar në SPE dokumentin Autorizim\_per\_tregtim\_te\_pajisjeve\_mjekesore, i cili rezulton me afat vlefshmërie deri më 30.06.2020. Ndërkohë kjo procedurë prokurimi është hapur më datë 04.08.2020, pra OE ka patur kohën e mjaftueshme për të ngarkuar në SPE autorizimin për tregtim të pajisjeve mjekësore të vlefshëm.

*Fillimisht ju informojmë se shoqëria BNT Electronics shpk është e autorizuar nga MSHMS për tregëtimin e pasjisjeve mjekësore bashkëngjitur autorizimi nr.10/220 datë 23.06.2020. Për këtë ju jeni absolutisht në dijeni pasi ky dokument lëshohet pikërisht nga institucioni juaj në këtë rast ka dhe rolin e AK.*

*Jemi të habitur se si e keni përdorur këtë arsye skualifikimi kur më misrë se ju askush tjetër nuk mund të dijë mbi autorizimin tonë që jemi të autorizuar.*

*Mosngarkimi i këtij dokumenti të përditësuar në këtë procedurë prokurimi që është zhvilluar nga vetë institucioni kompetent që autorizon dhe kontrollon autorizimet e gjithë shoqërive në shqipëri nuk është gjë tjetër përveçse një veprim krejtësisht i parëndësishëm dhe që nuk ka asnjë peshë as vlerë në këtë procedurë pasi cfardo dokumenti që lëshohet nga institucioni juaj dhe paraqitet nga një operator ekonomik ju duhet ta kontrolloni madje as nuk duhet ta kërkonin fare të paraqitet. Mjafton të kërkonin që OE të jetë i autorizuar por jo të paraqesë certifikatë/autorizim pasi këtë duhet ta verifikoni vetë si institucioni kompetent që e lëshoni këtë dokument.*

*Bashkëngjitur kësaj ankese po ju dërgojmë kopje të autorizimit të paraqitur në tender si dhe kopjen e autorizimit ku provohet se BNT Electronics shpk është autorizuar deri në 31 Dhjetor 2020. Sic vihet re nga të dyja autorizimet BNT Electronics është e autorizuar për të gjithë vitin 2020 pra nga data 01.01.2020 deri në datë 31.12.2020. BNT Electronics është e autorizuar gjatë gjithë kohës pra duke përfshirë edhe periudhën e tenderit të cilës ju i referoheni. Pa u futur më tej në detaje po ju bashkangjisim edhe autorizimin e ri që të mos mundoheni fare për të verifikuar dhe të cilën duhet ta pranoni si provë pasi ky autorizim është lëshuar nga institucioni juaj përpara datës së zhvillimit të tenderit pavarësisht se nuk është hedhur në sistemin e APP.*

*Lidhur me trajtimin e çështjeve të një natyre të tillë ju lutem referojuni dhe vetë vendimeve të KPP 613/2014 dhe KPP 664/2016 të KPP.*

*Sa më sipër pretendimi juaj nuk qëndron.*

- *Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit ku pretendoni se . Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST). Në specifikimet teknike të aparatit të mamografisë: 2.1. Është kërkuar në DST Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqendrim afërsisht 0,1 -0,3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1. \_Katalog\_Mamografi, specifikimi teknik lidhur me materialin e Anodës dhe materialin për filtrimin e rrezeve X nuk është markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjendet në katalog. Gjithashtu, OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimin të specifikimeve*

teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për specifikimin teknik të lartpërmendur përcakton vetëm fokusin 0.1mm/0.3mm, pa përmendur materialin e Anodës dhe materialin për filtrimin e rrezeve X.

Lidhur me këtë kriter kemi paraqitur katalogjet të përkthyer të noterizuara dhe të markuara sipas kërkesës suaj por sic specialistët e kësaj fushe janë në dijeni katalogjet përmbajnë dhe specifikimet teknike kryesore të pajisjes dhe jo të gjitha detajet periferike që ka një pajisje.

Duke qenë se katalogjet janë punë e prodhuesit dhe vendos ai se cfarë përfshin në katalog dhe cfarë jo si dhe duke qenë se në rastin konkret ky detaj i parëndësishëm nuk është i përfshirë në katalog ne kemi deklaruar në ofertën tonë teknike se e plotësojmë këtë kriter.

Materiali i anodës së pajisjes tonë është Molibdenum. Pra është material ekuivalent i atij që ju kërkoni. Tungsten dhe Molibdenum janë dy elementë që futen të dy në grupin e metaleve të rënda që përdoren për goditjet nga tufa elektronike për përfitimin e rrezeve X, rrjedhimisht për anodën e tubit të rrezeve X. Shumica e kompanive prodhuese të pajisjeve mjekësore të mirënjohura e përdorin për llampën e rrezeve X vecanërisht për sistemet e mamografive. Kompania Luna mini mund të prodhojë sisteme me anodë tungsteni por sic dihet Molibden është më i mirë për imazhimin e indeve të buta ndërsa Tungsten përdoret kryesisht për imazhimin e kockave pasi ka emetim të rrezatimit X shumë të madh nisur nga kushtet elektrike tendison dhe rrymë. Kjo është arsyeja që kemi ofertuar me këtë material. AK përpara se të vijonte me skualifikimin e ofertës tonë për këtë arsye duhej fillimisht të përdorte mjetin që njeh ligji kërkesën për sqarim bazuar në nenin 53 të LPP shqyrtimi i ofertave pika 1 duhej të na drejtohej me një kërkesë për sqarim përpara në mënyrë që të bënte një vlerëim sa më të drejtë të ofertës dhe jo të vazhdonte direkt me skualifikimin e ofertës sonë.

Në bazë të nenit 23 vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Në rastin konkret materiali i anodës së pajisjes sonë jo vetëm që i plotëson kushtet për të qenë e pranueshme por madje i tejkalon kërkesat duke e bërë atë më të favorshme për sa kohë që materiali Molibden është më i mirë për imazhimin e indeve të buta ndërsa Tungsten përdoret kryesisht për imazhimin e kockave pasi ka emetim të rrezatimit X shumë të madh nisur nga kushtet elektrike tension dhe rrymë.

Për sa më sipër as ky pretendim nuk qëndron.

- Lidhur me pikën e tretë të skualifikimit ku pretendoni: Është kërkuar në DST Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1. \_Katalog\_Mamografi, ky specifikim nuk është markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjendet në katalog. Gjithashtu, OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_ teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimin të specifikimeve teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për këtë specifikim ka deklaruar N/A, pra që nuk aplikohet faktor zmadhimi. Si rrjedhojë, nuk plotëson kërkesën sipas DST.

Ashtu sic jeni në dijeni katalogu përmban vetëm elementët më të rëndësishëm të pajisjes dhe jo cdo detaj periferik. Gjithsesi ne kemi deklaruar në ofertën tonë teknike që e plotësojmë këtë kriter dhe se deklarimi N/A është bërë për të qenë transparent me institucionin tuaj vetëm për arsye se në specifikimet teknike të pajisjes tonë nuk përdoret me termin e kërkuar nga ju por nga ana tjetër ne plotësojmë madje duke e tejkaluar atë me 10X më shumë.

Ju keni kërkuar Me pajisje zmadhimi jo më pak se 1,5X ndërkohë që pajisja jonë e ka 10 herë më të lartë.

Pra pajisja jonë e plotëson këtë kriter teknik dhe për ta provuar këtë ne kemi marrë deklaratë nga vetë prodhuesi që konfirmon pasqijes zmadhimi 10x në këtë deklaratë janë të gjitha të dhënat dhe kontaktet e prodhuesit ku mund ta verifikoni dhe vetë në rast dyshimesh.

Gjykojmë se AK ka nxituar me vendimarrjen e tij për të na skualifikuar pasi bazuar në LPP neni 53 shqyrtimi i ofertave pika 1 duhej të na drejtohej me një kërkesë për sqarim përpara në mënyrë që të bënte një vlerësim sa më të drejtë të ofertës dhe jo të vazhdonte direkt me skualifikimin e ofertës sonë.

Pra dhe ky pretendim i juaji nuk qëndron.

- Lidhur me pikën e katërt të skualifikimit ku pretendoni Është kërkuar në DST Distanca nga burimi tek imazhi 65-66 cm, ndërsa në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_ Mamografi, rezulton SID(source to image distance)  $\geq 600\text{mm}$ , e cila është një vlerë dysheme që nuk garanton kërkesën sipas DST.

Vihet re një veprim i nxituar i AK për të na skualifikuar pasi sic edhe vetë ju jeni shprehur distanca e ofertuar në specifikimet tona është SID (source to image distance) $>600\text{ mm}$  pra është më e madhe se 60 cm, meqënëse ju e paskeni konsideruar si një specifikim teknik të rëndësishëm sa që na keni skualifikuar, gjykojmë se duhet të ishit thelluar pak më tepër përpara se të vijonit me skualifikimin e ofertës tonë. Ju e dini se më e madhe se 60 cm përfshin numrat nga 60 dhe në infinit. Pra ju në zbatim të LPP duhej të na drejtoheshit me një kërkesë për sqarim. Për tju informuar juve pasqija qe ne kemi ofertar e ka distancën nga burimi tek imazhi 66 cm. Për këtë kemi marrë edhe deklaratën nga prodhuesi ku konfirmon këtë kriter.

- Lidhur me pikën e pestë të skualifikimit ku pretendoni se Është kërkuar në DST Ërkstation: Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruet. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_ Mamografi, rezulton Hard disc 500GB, duke mos plotësuar kështu kërkesën sipas DST.

Jemi të habitur se si trajtoni madhësinë e hardiskut sim jet për ta na skualifikuar kur cdokush jo vetëm specialistët e fushës e dinë se hardisku është një element që mund të ofrohet sipas kërkesës tuaj. Në katalog është e shkruajtur Hard Disk : 500G sepse

është një katalog standart për këtë pajisje por kjo nuk do të thotë se nuk mund të ofrohet një hardisk më i madh. Jemi të habitur se si për këtë arsye që as arsye skualifikimi nuk është vraponi për të skualifikuar ofertën që plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe teknike me cmimin më të ulët dhe për të lënë mundësinë e kualifikimit të një oferte me vlerë të koniderueshme më të lartë dhe që kuptohet të gjitha i ngarkohen buxhetit të shtetit. Gjithsesi pajisja jonë është me hard disk 2TB dhe këtë e vërtetojmë nga atatment i prodhuesit.

*Pra pretendimi juaj nuk qëndron.*

- Lidhur me pikën e fundit të skualifikimit Është kërkuar në DST Ëorkstation: I pajisur me Ups 1000VA.... Sistem operativ Ëindoës 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, këto specifikime teknike nuk janë markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjenden në katalog. OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimi të specifikimeve teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për specifikimet teknike të sipër cituara ka deklaruar Ok, por duke qënë se OE në këtë rast nuk është vetë prodhues, por nënkontraktor i autorizuar nga prodhuesi, deklarimi në ofertën teknike nuk krijon besueshmëri për plotësimin e specifikimeve për UPS dhe sistemin operativ për Ëorkstation

*Ashtu sic edhe ju jeni shprehur se deklarimi ynë nuk është i besueshëm pasi nuk është lëshuar nga prodhuesi atherë po ju koonfirmojmë se UPS është pjesë e paketës si dhe po ju vendosim në dispozicion deklaratën nga prodhuesi ku merr përsipër se pajisja do të jetë e pajisur me UPS 1000VA.*

*Pra edhe ky pretendim i juaji nuk qëndron.*

*Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë.*

II.9. Me shkresën nr.106 prot datë 31.08.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës . Ankimuesi ka marrë djeni lidhur me kthim përgjigjen nëpërmjet shërbimit postar më datë 09.09.2020.

II.10. Në datën 14.09.2020 operatori ekonomik ankimues “BNT Electronics” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr.2073/113 prot datë 21.09.2020 protokolluar me tonën me nr. 1084/2 prot datë 23.09.2020 dhe shkresën me nr.2073/114 datë 22.09.2020 protokolluar me tonën me nr.1109/2 datë 24.09.2020 me objekt “Dërgohet informacioni”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e BOE “Saer Medical” shpk & “Helath&Light” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik Montal shpk me arsyetimin se *Kemi informacion se kompania e klasifikuar e para nuk ka paraqitur një ofertë të pranueshme teknike. Më konkretisht për pajisjen Mamografi Dixhitale është kërkuar në specifikimet teknike : Ëorkstation Të instalohen në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitorë LCD min 19’’ me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD/DVD regjistruar. Nëpërmjet kësaj kërkesë teknike kuptohet qartazi një ëorkstation që shërben për rishikimin e imazheve të mamografisë pasi e kërkon të jetë instaluar në dhomën e diagnostikimit (dhomën ku jepet diagnoza, dhoma e mjekut), përvec asaj normales që vendoset në dhomën e ekzaminimit (të teknikut të radiologjisë). Gjithashtu kërkesa për dy monitorë nënkupton qartazi që kërkohet një ëorkstation rishikimi (stacioni i punës i mjekut) pasi nuk ka si të kërkohen dy monitorë për konsolen e mamografisë kur ajo nuk është e pajisur me Stereotaksi apo biopsi. Jemi të bindur dhe kemi informacion që operatori ekonomik Montal shpk i renditur i pari nuk ka përfshirë në ofertën e tij një ëorkstation rishikimi por vetëm konsolën e mamografisë të pajisur me dy monitorë nga të cilët njëri nuk ka për të qenë funksional dhe tregon që oferta nuk është e plotë. KY fakt duhet të verifikohet dhe kompania e renditur e para duhet të skualifikohet pasi oferta e saj nuk është konform specifikimeve teknike të kërkuara në procedurën e prokurimit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).*

III.1.2. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” datë 09.06.2020 të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

**Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike” LOT 3 – Pajisje Radiologjike, të procedurës së sipërcituar, bëhen këto ndryshime:**

|                                                                                                                                                                                            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1. MAMOGRAFI DIXHITALE</b>                                                                                                                                                              |
| <i>Sistemi me rreze X të mamografisë së integruar, për ekzaminimet dixhitale FFDM (Full Field Digital Mammography) bazuar në teknologjinë e Flat Panel për ekzaminim dhe diagnostikim.</i> |
| <i>Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbeshtetese.</i>                                                                             |
| <i>Sistemi duhet të garantojë cilësinë më të lartë të imazhit dhe riprodhueshmërinë dhe duhet të ofrojë risi teknologjike</i>                                                              |
| <i>Struktura mbrojtëse ndaj rrezatimit të jete e përfshirë</i>                                                                                                                             |
| <i>Gjenerator me rreze X me fuqi të pakten 5kE në 35kV</i>                                                                                                                                 |
| <i>Te kontrollohet me mikroprocesor një fazor, me frekuencë të lartë, me fuqi të lartë</i>                                                                                                 |
| <i>Gama e tensionit: afërsisht 20-35 KV</i>                                                                                                                                                |
| <i>Gama e mAs: 1 – 600 mA/s</i>                                                                                                                                                            |
| <i>Te ketë mbrojtje të tubit të rrezeve X nga mbingarkesa termike me sensor aktiv temperature të kontrolluar nga njesia qendrore.</i>                                                      |
| <i>Përzgjedhja e parametrave radiologjikë të jete automatikisht bazuar në densitetin e gjirit</i>                                                                                          |
| <i>Kompensim automatik të tensionit</i>                                                                                                                                                    |
| <i>Doze minimale për pacientin</i>                                                                                                                                                         |
| <i>Kolimator automatik,</i>                                                                                                                                                                |
| <i>I pajisur me llambe Led</i>                                                                                                                                                             |
| <i>Tubi I rrezeve X</i>                                                                                                                                                                    |
| <i>Shpejtesia e rrotullimit të anodes jo më pak se 3000 rpm</i>                                                                                                                            |
| <b><i>Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqendrim afërsisht 0,1-0,3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent.</i></b>                               |
| <i>Kapaciteti i nxehtësisë jo më pak se 300 kHU</i>                                                                                                                                        |
| <i>Rrotullimi Gantry për afërsisht: 0 ° / + 90 °; 0 ° / -150 ° i motorizuar,</i>                                                                                                           |
| <i>Rrotullim i motorizuar izocentrik i krahut</i>                                                                                                                                          |
| <i>Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frenë elektromagnetike</i>                                                                                                          |
| <i>Sistemi I shtypjes</i>                                                                                                                                                                  |
| <i>Manual dhe i motorizuar me kode të ndryshme kompresimi</i>                                                                                                                              |
| <i>Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X</i>                                                                                                                                              |
| <i>Kompresimi (madhësi dhe teknika të ndryshme)</i>                                                                                                                                        |
| <i>Afishim dixhital i forces së kompresimit, trashësisë, këndit, etj</i>                                                                                                                   |
| <i>Kontroll me motor lart ose poshtë me pedal të kembet,</i>                                                                                                                               |
| <i>Celesa rregulluese në të dy anët e ngjeshjes. Pajisje për rregullim të mirë</i>                                                                                                         |
| <i>Paneli i sheshtë</i>                                                                                                                                                                    |
| <i>Madhësia aktive e detektorit jo më pak se 24x30 cm</i>                                                                                                                                  |
| <i>Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR.</i>                                                                                                                              |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Madhësia e pikselit, maksimum 90 µm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <i>Perftim optimal i imazhit për të gjithë ekranin me rezolucion të plotë të gjirit</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <i>Për imazhim optimal të përfshirë përdorimin e AEC</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <i>Distanca nga burimi tek imazhi 65-66 cm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Levizje vertikale min 45-125 cm*</i><br>*Sqarim<br>Në lidhje me specifikimin teknik 45-125 cm në këtë rast nënkupton që lëvizja vertikale si vlerë të jetë brenda këtij diapazoni. Pikërisht për të mundësuar pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve dhe për të nxitur konkurrencën, në specifikimet e kësaj procedure është vendosur nga AK ky diapazon për lëvizjen vertikale dhe jo një vlerë fikse. Si rrjedhojë vlerat si 57, 60cm, 70cm, 75 cm do të konsiderohen në përputhje me kërkesën e DST-së. |
| <i>Sistemi duhet të perftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning)</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <i>Ëorkstation</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <i>I pajisur me Ups 1000VA.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <i>Te jete pajisur me printer per printimin e filmave.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b><i>Rezolucioni i printerit të jetë min 300dpi.</i></b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b><i>Sistem operativ Ëindoës 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente.</i></b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <b><i>2.GRAFI DIXHITALE</i></b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| <i>Aparat grafie i montuar ne dysHEME</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <i>Me gjenertaor me frekuence te larte</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <i>Te jete i kontrolluar me mikroprocesor</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>Te kete kontroll me KV, mA, kohe/ mAs</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <i>te kete sistem mbrojtjeje per mbingarkesen e llampes</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <i>Te jete i pajisur me qarqe vetë diagnostikimi me raportim kode-gabimi</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <i>Te perbehet nga, Gjeneratori, Llampa rrezeve X, Kolona dhe mbajtësi i llampes, Kolimatori, Tavolina e radiografike, Bucky-it vertical, Dedektori dhe stacioni i punes.</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>Sistemi i marrjes dhe perpunimit te te dhenave</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <i>Gjenerator i frekuences se larte per diagnostikim te cilesise se larte te imazhit , Frekuenca jo me e vogel se 100 kHz</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>Fuqia e gjeneratorit jo me e vogel se 50kV</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| <i>Rryma radiografike: minimalisht 600 mA@70kV</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>Diapazoni mAs nga 0.5 deri ne 500 mAs</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <i>Tensioni radiografik: nga 40 deri ne 150kV,</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>Sistem vete diagnostikimi</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <i>Kontroll me mikroprocesor</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <i>Llampa e rrezeve X</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <i>Voltazhi maksiamal i llampes 150kV</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Tekete 2 spotefokale</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <i>Spoti fokal minimal 0.6</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>Spoti fokal maksimal 1.2</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Sistem ftohes i llampes</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>Kapaciteti i ruajtjes se nxehtesise se anodes jo me i vogel se 300 kHU</i>                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <i>E pajisur me filtrim alumini</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>Mbajtësi i llampes dhe kolona e levizshme per llampen e rrezeve X</i>                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <i>Te kete levizje vertikale dhe horizontale te krahut te tubit, me frena elektrike</i>                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Rrotullim i Tubit te pakten 90/180°</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <i>Te kete kycje elektromagnetike</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <i>Tavoline Radiografie me bucky</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <i>Tavolina me suprinen e siperme te levizshme me frena elektrike</i>                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b><i>Permasat e suprines se tavolines min 74-75cm x 210-220cm.</i></b>                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Lartesia approx. 60 cm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <i>Diapazoni i levizjes se suprines se tavolines min : gjatesore approx. 80 cm, transversale approx. 20 cm</i>                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>Bucky vertical,</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <i>Diapazon levizje vertikale 130 cm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <i>Mbajtje vertikale te kunderbalancuar,</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <i>Frena elektrike per pozicionim te lehte dhe fiksim</i>                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <i>Receptor imazhi</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <i>Dedektori dixhital</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <i>Permasa 43X35 cm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Pixel matrix 2800 x 2300</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Pixel pitch 140 µm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <i>Sistemi i marrjes se te dhenave</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <i>Softëare per marrjen e te dhenave, Lidhje PACS dhe DICOM 3.0</i>                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>Mundesitë zgjedhjeje per nderfaqe te thjeshte</i>                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <i>Modulet diagnostikuese, softëare per imazhet, ndertim te listes se punes, perpunim, printim,</i>                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>DICOM</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <i>Perfshire nje PC, tastjere, mouse dhe kabllot e nevojshem.</i>                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <i>Procesor dual core ose me i mire, min 2 GB RAM, 500 GB hard disk ose me shume</i>                                                                                                                                                                                                                                           |
| <i>Printer dixhital dry</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b><i>Printer i thatë mjekësor (Dry printer), se paku 300 dpi; Dry Printer duhet te kete teknologjine lazer dhe jo termik; Duhet te printoje se paku 70 filma/ore 35x43cm; Duhet te printoje ne 3 formate filmash; Formatet e printimit 35x43, 26x36 dhe 20x25 cm; Te furnizohen edhe 5 pako filma per secilin format.</i></b> |
| <i>Monitor LCD min 19"</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Montal” shpk në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Katalogë Teknikë nga prodhuesi Medi-Future për artikullin nr.1 Mamografi Dixhitale. Në tabelën e specifikimeve teknike të katalogut për Stacionin e Punës së akuizicionit –Konsola e stacionit të punës pëshkruhet dhënat teknike se konsola është e pajisur me ekran led me prekje 21.5’’ full HD me rezolucion të monitorit 1,920x1,080.
- Letër përputhshmërie teknike lëshuar nga prodhuesi për produktin “sistem mamografie soul indirect” ku rezulton se për specifikimin teknik të kërkuar në dokumentat e tenderit për Ëorkstation -dy monitorë LCD min 19’’ me rezolucion 1600x1200 është deklaruar Ëorkstation-dy monitorë 21.5’’ Full HD LED me prekje , Rezolucioni i Monitorit 1920x1080.

III.1.4. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

III.1.5. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPPdhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.

III.1.6. Në nenin 46, të LPP-së parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. b) aftësia

teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.1.7. Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.8. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht: *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*
- c) *c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.9. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

II.1.10. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Ndërsa në specifikimet teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton

se për pajisjen mamografi nga ana e autoriteti kontraktor rezulton të jetë përcaktuar për *Workstation - Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruet.* Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Montal shpk në përmbushje të këtij specifikimi teknik për të cilën operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk është përmbushur nga ky operator, KPP konstaton se dokumentacioni katalogë teknike dëshmon qartë se Konsola e stacionit të punës është e pajisur me ekran led me prekje ndërsa dokumenti letër përputhshmërie i cili është lëshuar nga prodhuesi dhe ka të njëjtën vlerë si katalogët dëshmon se Workstation është i pajisur me dy monitorë.

KPP gjykon se operatori ekonomik "Montal" shpk me dokumentacionin e paraqitur dëshmon se plotëson specifikimet teknike për pajisjen mamografi dixhitale pasi në katalogët teknike dhe letër përputhshmërie lëshuar nga prodhuesi përcaktohet qartë se edhe konsola e stacionit të punës ashtu edhe dhoma e diagnostikimit janë të pajisur me monitorë me rezolucionin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në këtë kuptim KPP gjykon se pretendimi i BOE ankimues se operatori ekonomik Montal shpk i renditur i pari nuk ka përfshirë në ofertën e tij një ëorkstation rishikimi por vetëm konsolën e mamografisë të pajisur me dy monitorë nga të cilët njëri nuk ka për të qenë funksional dhe tregon që oferta nuk është e plotë, nuk qëndron në rastin konkret pasi në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori Montal shpk shprehet qartë se dhoma e diagnostikimit është e pajisur me dy monitorë sikundër kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi përveç monitorit në Konsolën e stacionit të punës.

Sa më sipër pretendimi i BOE ankimues "Saer Medical" shpk & "Helath&Light" shpk nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik "BNT Electronics" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se *Në specifikimet teknike të aparatit të mamografisë:*

2.1. *Është kërkuar në DST Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me perqendrime afërsisht 0,1 -0,3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, specifikimi teknik lidhur me materialin e Anodës dhe materialin për filtrimin e rrezeve X nuk është markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjendet në katalog. Gjithashtu, OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimin të specifikimeve teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për specifikimin teknik të lartpërmendur përcakton vetëm fokusin 0.1mm/0.3mm, pa përmendur materialin e Anodës dhe materialin për filtrimin e rrezeve X.*

2.2. Është kërkuar në DST Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, ky specifikim nuk është markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjendet në katalog. Gjithashtu, OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimit të specifikimeve teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për këtë specifikim ka deklaruar N/A, pra që nuk aplikohet faktor zmadhimi. Si rrjedhojë, nuk plotëson kërkesën sipas DST.

2.4. Është kërkuar në DST Ëorkstation: Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19” me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, rezulton Hard disc 500GB, duke mos plotësuar kështu kërkesën sipas DST.

2.5. Është kërkuar në DST Ëorkstation: I pajisur me Ups 1000VA.... Sistem operativ Ëindoës 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente. Në katalogun e paraqitur nga ky OE 1.\_Katalog\_Mamografi, këto specifikime teknike nuk janë markuar sipas përcaktimeve në LPP dhe nuk gjenden në katalog. OE ka paraqitur dhe dokumentin MSH\_oferte\_teknike\_Loti\_3, ku i referohet plotësimit të specifikimeve teknike për modelet e ofruara të pajisjeve, dhe për specifikimet teknike të sipër cituara ka deklaruar Ok, por duke qënë se OE në këtë rast nuk është vetë prodhues, por nënkontraktor i autorizuar nga prodhuesi, deklarimi në ofertën teknike nuk krijon besueshmëri për plotësimin e specifikimeve për UPS dhe sistemin operativ për Ëorkstation” Komisioni i Prokurimit Pubik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofertuar ku të jenë të pasqyruara specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Në katalogë, duhet të shenohet sipas numrit të artikullit në Formularin e Ofertes dhe të markohen me ngjyrë të ndezur (të verdhë), artikujt e ofruar. (Katalogët duhet të ngarkohen në [eëë.app.gov.al](http://eëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT. Përshkrimi teknik duhet të jetë i përkthyer në gjuhën shqipe në pjesët që kanë lidhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST).

III.2.2. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentat e tenderit” datë 09.06.2020 të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektornike përcaktohet si më poshtë:

**Në Shtojcën 10 të DST “Specifikimet Teknike” LOT 3 – Pajisje Radiologjike, të procedurës së sipërcituar, bëhen këto ndryshime:**

|                                                                                            |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>1. MAMOGRAFI DIXHITALE</b>                                                              |
| Sistemi me rreze X të mamografisë së integruar, për ekzaminimet dixhitale FFDM (Full Field |

|                                                                                                                                                       |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Digital Mammography) bazuar në teknologjinë e Flat Panel për ekzaminim dhe diagnostikim.                                                              |
| Mburoja e rrezatimit në përputhje me mbrojtjen standarde EN60601-1-3. Të përfshihet kolona mbeshtetese.                                               |
| Sistemi duhet të garantojë cilësinë më të lartë të imazhit dhe riprodhueshmërinë dhe duhet të ofrojë risi teknologjike                                |
| Struktura mbrojtese ndaj rrezatimit të jete e përfshirë                                                                                               |
| Gjenerator me rreze X me fuqi të pakten 5kE në 35kV                                                                                                   |
| Te kontrollohet me mikroprocesor një fazor, me frekuencë të lartë, me fuqi të lartë                                                                   |
| Gama e tensionit: afërsisht 20-35 KV                                                                                                                  |
| Gama e mAs: 1 – 600 mAs                                                                                                                               |
| Te ketë mbrojtje të tubit të rrezeve X nga mbingarkesa termike me sensor aktiv temperature të kontrolluar nga njesia qendrore.                        |
| Përzgjedhja e parametrave radiologjikë të jete automatikisht bazuar në densitetin e gjirit                                                            |
| Kompensim automatik të tensionit                                                                                                                      |
| Doze minimale për pacientin                                                                                                                           |
| Kolimator automatik,                                                                                                                                  |
| I pajisur me llambe Led                                                                                                                               |
| Tubi I rrezeve X                                                                                                                                      |
| Shpejtesia e rrotullimit të anodes jo më pak se 3000 rpm                                                                                              |
| <b>Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqendrim afërsisht 0,1-0,3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent.</b> |
| Kapaciteti i nxehtësisë jo më pak se 300 kHU                                                                                                          |
| Rrotullimi Gantry për afërsisht: 0 ° / + 90 °; 0 ° / -150 ° i motorizuar,                                                                             |
| Rrotullim i motorizuar izocentrik i krahut                                                                                                            |
| Rregullimi i lartësisë i motorizuar rreth 75 cm, me frenë elektromagnetike                                                                            |
| Sistemi I shtypjes                                                                                                                                    |
| Manual dhe i motorizuar me kode të ndryshme kompresimi                                                                                                |
| Me pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X                                                                                                                |
| Kompresimi (madhësi dhe teknika të ndryshme)                                                                                                          |
| Afishim dixhital i forcës së kompresimit, trashësisë, këndit, etj                                                                                     |
| Kontroll me motor lart ose poshtë me pedal të kembet,                                                                                                 |
| Celesa rregulluese në të dyanët e ngjeshjes. Pajisje për rregullim të mirë                                                                            |
| Paneli i sheshtë                                                                                                                                      |
| Madhësia aktive e detektorit jo më pak se 24x30 cm                                                                                                    |
| Detektor me të paktën 60% DQE të matur nën dozën 10mR.                                                                                                |
| Madhësia e pikselit, maksimum 90 μm                                                                                                                   |
| Perftim optimal i imazhit për të gjithë ekranin me rezolucion të plotë të gjirit                                                                      |
| Për imazhim optimal të përfshirë përdorimin e AEC                                                                                                     |
| Distanca nga burimi tek imazhi 65-66 cm                                                                                                               |
| Levizje vertikale min 45-125 cm*                                                                                                                      |
| *Sqarim                                                                                                                                               |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Në lidhje me specifikimin teknik 45-125 cm në këtë rast nënkupton që lëvizja vertikale si vlerë të jetë brenda këtij diapazoni. Pikërisht për të mundësuar pjesëmarrjen e sa më shumë operatorëve dhe për të nxitur konkurrencën, në specifikimet e kësaj procedure është vendosur nga AK ky diapazon për lëvizjen vertikale dhe jo një vlerë fikse. Si rrjedhojë vlerat si 57, 60cm, 70cm, 75 cm do të konsiderohen në përputhje me kërkesën e DST-së. |
| Sistemi duhet të përftojë imazhe mundësisht duke përdorur madhësinë origjinale të pikselit (teshmange pixel binning)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Ërkstation                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Të instalohet në dhomën e diagnostikimit me monitorë me 2 monitore LCD min 19" me rezolucion 1600x1200 dhe hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve. Duhet të përfshihet CD / DVD regjistruar.                                                                                                                                                                                                                                                            |
| I pajisur me Ups 1000VA.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Te jete pajisur me printer per printimin e filmave.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <b>Rezolucioni i printerit të jetë min 300dpi.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <b>Sistem operativ Ëindoës 7/10 ose më mirë ose sisteme operative ekuivalente.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <b>2.GRAFI DIXHITALE</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Aparat grafie i montuar ne dysHEME                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Me gjenertaor me frekuence te larte                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| Te jete i kontrolluar me mikroprocesor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Te kete kontroll me KV, mA, kohe/ mAs                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| te kete sistem mbrojtjeje per mbingarkesen e llampes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Te jete i pajisur me qarqe vetë diagnostikimi me raportim kode-gabimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Te perbehet nga, Gjeneratori, Llampa rrezeve X, Kolona dhe mbajtësi i llampes, Kolimatori, Tavolina e radiografike, Bucky-it vertical, Dedektori dhe stacioni i punes.                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Sistemi i marrjes dhe perpunimit te te dhenave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Gjenerator i frekuences se larte per diagnostikim te cilesise se larte te imazhit , Frekuenca jo me e vogel se 100 kHz                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Fuqia e gjeneratorit jo me e vogel se 50kË                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Rryma radiografike: minimalisht 600 mA@70kV                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Diapazoni mAs nga 0.5 deri ne 500 mAs                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Tensioni radiografik: nga 40 deri ne 150kV,                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Sistem vete diagnostikimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Kontroll me mikroprocesor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Llampa e rrezeve X                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Voltazhi maksiamal i llampes 150kV                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Tekete 2 spotefokale                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Spoti fokal minimal 0.6                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Spoti fokal maksimal 1.2                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| Sistem ftohes i llampes                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Kapaciteti i ruajtjes se nxehtesise se anodes jo me i vogel se 300 kHU                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| E pajisur me filtrim alumini                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Mbajtesi i llampes dhe kolona e levizshme per llampen e rrezeve X</i>                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <i>Te kete levizje vertikale dhe horizontale te krahut te tubit, me frena elektrike</i>                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Rrotullim i Tubit te pakten 90/180°</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <i>Te kete kycje elektromagnetike</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <i>Tavoline Radiografie me bucky</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| <i>Tavolina me suprinen e siperme te levizshme me frena elektrike</i>                                                                                                                                                                                                                                                          |
| <b><i>Permasat e suprines se tavolines min 74-75cm x 210-220cm.</i></b>                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Lartesia approx. 60 cm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| <i>Diapazoni i levizjes se suprines se tavolines min : gjatesore approx. 80 cm, transversale approx. 20 cm</i>                                                                                                                                                                                                                 |
| <i>Bucky vertical,</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <i>Diapazon levizje vertikale 130 cm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| <i>Mbajtje vertikale te kunderbalancuar,</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| <i>Frena elektrike per pozicionim te lehte dhe fiksime</i>                                                                                                                                                                                                                                                                     |
| <i>Receptor imazhi</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <i>Dedektori dixhital</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <i>Permasa 43X35 cm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| <i>Pixel matrix 2800 x 2300</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
| <i>Pixel pitch 140 µm</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| <i>Sistemi i marrjes se te dhenave</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| <i>Softëare per marrjen e te dhenave, Lidhje PACS dhe DICOM 3.0</i>                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>Mundesia zgjedhjeje per nderfaqe te thjeshte</i>                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| <i>Modulet diagnostikuese, softëare per imazhet, ndertim te listes se punes, perpunim, printim, DICOM</i>                                                                                                                                                                                                                      |
| <i>Perfshire nje PC, tastjere, mouse dhe kabllot e nevojshem.</i>                                                                                                                                                                                                                                                              |
| <i>Procesor dual core ose me i mire, min 2 GB RAM, 500 GB hard disk ose me shume</i>                                                                                                                                                                                                                                           |
| <i>Printer dixhital dry</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <b><i>Printer i thatë mjekësor (Dry printer), se paku 300 dpi; Dry Printer duhet te kete teknologjine lazer dhe jo termik; Duhet te printoje se paku 70 filma/ore 35x43cm; Duhet te printoje ne 3 formate filmash; Formatet e printimit 35x43, 26x36 dhe 20x25 cm; Te furnizohen edhe 5 pako filma per secilin format.</i></b> |
| <i>Monitor LCD min 19"</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “BNT Electronics” shpk në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Ofertë Teknike e OE BNT Electronics
- Katalogë Teknikë të prodhuesit Luna Mini

III.2.4. KPP pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi vëren se ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe

specifikimeve teknike të pasqyruara në katalogët teknikë të ankimuesit. Konkretisht KPP konstaton se specifikimi teknik Anoda të jetë prej Tungstenit ose më mirë për të zvogëluar dozën me përqendrim afërsisht 0,1-0,3 mm dhe filtrim me material Al ose ekuivalent, nuk gjen pasqyrim në katalogun e dorëzuar nga ankimuesi. Ndryshe nga sa pretendohet në ankesën e operatorit se ai ka ofertuar material më të mirë molibdenum KPP vëren se nuk deklarohet në asnjë dokument as në dokumentin ofertë teknike të cilën ankimeusi e ka paraqitur si dokument mbështetës të ofertës së tij për përmbushen e specifikimeve teknike megjithëse ky nuk është një dokument që kërkohet në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe as nuk mund të ketë vlerën e katalogut apo të një dokumenti të lëshuar nga prodhuesi në kushtet kur plotësohet nga vetë operatori ekonomik.

Gjithashtu KPP vëren se specifikimi teknik i kërkuar në dokumentat e procedurës objekt ankimi pajisje zmadhimi: jo më pak se 1,5X, nuk gjen pasqyrim në katalogun e paraqitur nga ankimuesi. Akoma më tej në dokumentin ofertë teknike ankimuesi për këtë specifikim ka deklaruar N/A, pra që nuk aplikohet faktor zmadhimi. Mospërputhje gjenden edhe sa i takon specifikimit lidhur me hard disk 2 TB për ruajtjen e imazheve për ëorkstation të kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi pasi në katalogun e paraqitur nga BNT Electronics shpk, rezulton Hard disc 500GB, duke mos plotësuar kështu kërkesën sipas DST, si dhe specifikimit teknik Ëorkstation: I pajisur me Ups 1000V nga ku rezulton se ky specifikim nuk rezulton të jetë pasqyruar në katalogun e dorëzuar nga ankimuesi por thjesht një deklaram në ofertën teknike se e plotëon këtë specifikim.

Akoma më tej referuar deklarimeve të vetë ankimusit në ankesë ky i fundit pranon se ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të pajisjeve të ofruara prej tij dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi duke pretenduar se këto janë detaje të parëndësishme dhe duke pretenduar se katalogët nuk përmbajnë të gjitha detajet periferike që janë kërkuar në rastin konkret. KPP sqaron se edhe nëse katalogët nuk përmbajnë të gjitha specifikimet operatori duhet të tregohet i kujdesshëm dhe plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara duke gjetur mënyrën për të vërtetuar plotësimin e tyre edhe nëpërmjet një dokumenti shtesë nga prodhuesi ku të pasqyrohet se specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor mund të përmbushen, pasi operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë ofertën e tij në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Në këtë kuptim, Komisioni gjykon se ankimuesi në kushtet kur edhe vetë pranon se nuk mund të përmbushë kërkesat e autoritetit kontraktor është i destinuar të dështojë në realizimin me sukses të kësaj kontrate kjo pasi pajisjet që ky ofertues do të ofrojë nuk do të jenë në përputhje me specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor

III.2.5. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit., Kriteret për kualifikim

vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.6. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatorët ekonomikë do të kishin pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit kanë patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se *"Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni"*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se *"[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]"*.

Sa më sipër Komisioni gjykon se operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike në lidhje me produktet sipas përcaktimeve të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, duke mos dëshmuar se gëzon kapacitete për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Saer Medical” shpk & “Helath&Light” shpk për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me Nr.REF-58406-05-18-2020, me objekt Loti 3 “F.V “Pajisje radiologjike” me fond limit 25,666,667 (njëzet e pesë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 04.08.2020 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr.1084 Protokoli, Datë 09.09.2020**

**Nr.1109 Protokoli; Datë 14.09.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaïd Myzyri**